



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:235991

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05450574

P.nr.522/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Rukije Matoshi, në çështjen penale ndaj të pandehurve D. P. nga L., pershkak te veprës penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK- së dhe H. P. nga L., pershkak te veprës penale Sulm nga neni 184 par.2 të KPRK-së, e të cilet i akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.2867/22 të dt.14.11.2022, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me datën 13.03.2024, në prani të prokurorit të shtetit Besnik Jakupi, të pandehurve dhe ne munges te te dëmtuarve, në po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të pandehurve:

1.D. P., nga i ati N., i lindur me datë ..., në L., me nr. të letërnjoftimit ..., me vendbanim në rr.“I. O.”, L., ku edhe jeton, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

2.H. P., nga i ati H., e lindur me datë ..., në L., me nr. të letërnjoftimit ..., me vendbanim në rr.“I. O.”, e martuar, Shqiptare, shtetase e Republikës se Kosovës.

J A N Ë F A J T O R

S E P S E

I akuzuari D. P.

Me dt.11.06.2022 rreth orës 17:30, në fshatin “J.”-L., i dyshuari pas një mosmarrëveshje të atëçastshme me tani të dëmtuarin K. Sh., në lidhje me përparësinë e kalimit në komunikacion pasi që paraprakisht e ndal veturën i dyshuari del nga vetura dhe me qëllim të dëmtimit të pronës së huaj në shenjë revolte me dorë e godet retrovizorin e veturës se të dëmtuarit dhe të njëjtën e dëmton duke e thyer ku edhe lëndon dorën e tij, me ç’rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material,

-Më këtë ka kryer veprën penale “Asgjësim apo dëmtim i pasurisë” nga neni 321 par.1 të KPRK- së.

E akuzuara H. P.,

Me datën, kohën dhe vendin e njëjtë të përshkruar si në dispozitivin nën I të kësaj aktakuze, derisa i dyshuari D.-djali i saj kishte mosmarrëveshje me të dëmtuarin K. Sh., e njëjta del nga vetura merr në dorë një kockë betoni dhe e ka sulmuar te dëmtuarin duke e gjuajtur dhe goditur ne krahë,

-Me këtë ka kryer veprën penale “Sulm” nga neni 184 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69 dhe neni 321 par. 1 të KPRK-së, nenit 184 par. 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurit iu shqipton:

DËNIM ME GJOBË DHE ME KUSHT

Të akuzuarin e parë D. P., me dënim me gjobë në shumë prej 100-€, të cilin dënim i pandehuri është e obliguar që ta paguaj në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim, konfrom nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

Të akuzuarën e dytë H. P., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 viti nuk do të kryen asnjë vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

I dëmtuari K. Sh. nga J. për kërkuesën pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

DETYROHEN të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajnë secili veç e veç në emër të paushallit gjyqësor shumë nga 20-€, si dhe shumë në mënyrë solidare prej 20-€, në Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.2867/22 të dt.14.11.2022, i ka akuzuar të akuzuarit D. P. nga L., pershkak te veprës penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK- së dhe H. P. nga L., pershkak te veprës penale Sulm nga neni 184 par.2 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve sepse ky pranim i fajësisë ka mbështetje në dispozitat ligjore, duke i propozuar gjykatës që të aprovoi pranimin e fajësisë.

I akuzuari i parë ne shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranonë fajsinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe njiherit ka shtuar se ditën kritike ka qenë i rrahur nga të dëmtuarit dhe për shkak të asaj gjendje nuk di qka ka bërë. Është në gjendje jo të mirë shëndetësore dhe po ashtu jo të mirë ekonomike vuan nga smundja egzofakut, për qka i duhen mjetet financiare për shërim jashtë vendit ka kërkuar nga gjykata që ti ketë parasysh këto rrethana dhe ti shqiptoj një dënim sa më të but.

E akuzara e dytë se shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se e pranonë fajsinë për veprën penale për të cilën akuzohet mirëpo shtonë se ditën kritike ka ndodhur mosmarrëveshja rastësisht në komunikacion ku për shkak të prekjes së veturave ka ardhur deri te mosmarrëveshja mes të dëmtuarit dhe djalit tim dhe pasi ka filluar ngatresa unë për ti ndar dhe mos me u ba ma e madhe ka dal dhe është mundu me i nda mirëpo sa i përket pjesës së përgjegjësisë pendohet për atë që ka ndodhur dhe shpresonë se në të adhmën mos të ndodh kur e askujt mos ti ndodh, është mbajtëse e familjes nën e 4 anetarshe, D. është në gjendje jo të mirë shëndetësore nevojiten mjaftë financa për të shëruar dhe ka kërkuar nga gjykata që ti shqiptoj një dënim sa më të but.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se te akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pranimi i fajit nuk është rrezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve të kundërligjshme, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konformë nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarëve për veprat penale për të cilat akuzohen.

Matja dhe caktimi i dënimit

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin e parë D. P., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, rrethanat personale, pra faktin se i njëjti është në gjendje jo të mirë shëndetësore dhe i moshës së re që len për të kuptuar se në të ardhmën mund të bëhet anëtar i dobishëm i shoqërisë dhe i gjendjes së jo të mirë ekonomike, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të akuzuarin pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin e dytë H. P., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale, pra faktin se e njëjta për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare, pra faktin se e njëjta është e moshuar dhe nën e 4 fëmijëve qëë kujdeset për ta dhe e gjendjes së jo të mirë ekonomike, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se e njëjta është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të akuzuarën pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë e aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese por e ndikuar nga gjendja e krijuar në mes djalit të saj dhe të dëmtuarëve një situat e till e paprovokuar nga ana e sajë, dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtës i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 47 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, ku shuma secili veq e veq nga 20-€ në emër të paushallit gjyqësor u caktua ne baze te nderlikushmerise se rastit, ndërsa shuma prej 20-€ për kompenzimin e viktimave te krimite u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore-juridike

Vendimi për kërkesën pasurore-juridike u bazua në nenin 462 të KPPK-së, ashtu që gjykata e udhëzoi të dëmtuarin që kërkesën pasurore - juridike ta realizojë në procedurë të rregullt gjyqësore nga se gjykata në procedurën penale nuk ka pasur prova të mjaftueshme për ta vërtetuar lartësinë e dëmit respektivisht lartësinë e kërkesës pasurore-juridike andaj nga këto arsye të dëmtuarin e udhëzoi në kontestë të rregullt civil.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN
P.nr.522/2022 dt.13.03.2024

GJYQTARI
Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate

Numri i lëndës: 2022:235991
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05450574